



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 korrik 2013
Nr.ref.:RK433/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI66/13

Parashtrues

Milazim Gashi

kundër

Kryetarit të Komunës së Graçanicës, z. Bojan Stojanović.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Milazim Gashi (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi), me vendbanim në Graçanicë.

Pala kundërshtare

2. Pala kundërshtare është kryetari i Komunës së Graçanicës (në tekstin e mëtejme: pala kundërshtare).

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se *“nenet 62, 123 dhe 124 të Kushtetutës së Kosovës janë shkelur për shkak të mosveprimit të kryetarit të Komunës së Graçanicës, në lidhje me procedimin e çështjes për emërimin e nënkryetarit të kësaj komune.”*

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit, Nr. 03/L-121, për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 29 prill 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 29 prill 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 14 maj 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesi të gjitha dokumentet relevante në lidhje me emërimin ose mosemërimin e nënkryetarit të komunitetit joshumicë të Graçanicës, duke përfshirë:
 - a. Procesverbalin e seancave të Kuvendit Komunal të Graçanicës, ku është diskutuar çështja e emërimit ose mosemërimit të nënkryetarit të Komunës nga komuniteti joshumicë i Graçanicës;
 - b. Vendimet; dhe
 - c. Komunikimin me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.
8. Më 14 maj 2013, kërkesa iu komunikua palës kundërshtare.
9. Më 22 maj 2013, parashtruesi dorëzoi dokumentet shtesë të kërkuara.
10. Më 17 qershor 2013, Kryetari i Gjykatës e zëvendësoi gjyqtaren Arta Rama Hajrizi si anëtare të Kolegjit shqyrtues me gjyqtarin Enver Hasani.
11. Më 20 qershor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 1 mars 2010, partia politike Lidhja Demokratike e Dardanisë e njoftoi kryetarin e Komunës së Graçanicës se, *"në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale, neni 61, Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), e emëron z. Milazim Gashi në pozitën e nënkryetarit të Komunës, për Komunitete në Komunën e Graçanicës."*
13. Më 28 maj 2010, Kuvendi Komunal mbajti një mbledhje, ku njëra nga temat ishte zgjedhja e nënkryetarit të Komunës për Komunitete. Në Procesverbal të asaj mbledhjeje theksohet si në vijim:

"Kryesuesi i Komisionit për Komunitete theksoi se komuniteti i shqiptarëve nuk është i kënaqur se që 5 muaj nuk është zgjedhur nënkryetari nga komuniteti pakicë dhe se nënkryetari duhet të jetë nga komuniteti i shqiptarëve."

I.S., anëtar i Komisionit, deklaroi se në këtë pikë të rendit të ditës duhet të theksohet se komuniteti rom duhet të dorëzojë kërkesën për zgjedhjen e nënkryetarit, pasi që komuniteti rom është pakica më e madhe në komunën e Graçanicës me 10.6%, ndërsa komuniteti i shqiptarëve përbën 3.6% dhe ai goran 1.8% dhe se kryetari tanimë është në negociata me komunitetin rom."

A.K., anëtar i Komisionit, pajtohet me I.S., anëtar i Komisionit."

Kryesuesi i Komisionit për Komunitete pajtohet se komuniteti rom është më i madh se komuniteti shqiptar, por komuniteti shqiptar mori pjesë në zgjedhje dhe votuan për partinë e tyre, përderisa komuniteti rom kishte votuar për partinë "SLS", dhe se sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, neni 61, pika 61.3, nënkryetari për Komunitete propozohet nga kryetari i Komunës dhe duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë si dhe shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë e të cilët u përkasin komuniteteve joshumicë dhe pasi që ai vjen nga komuniteti pakicë, ai do të votojë për anëtarin e partisë së tij."

I.S., anëtar i Komisionit, deklaroi se sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, pika 61.1 në komunat ku së paku 10% e banorëve i takojnë komunitetit joshumicë, ata do të kenë një kryesues për komunitete dhe ai është komuniteti rom."

14. Më 7 qershor 2010, Kuvendi Komunal mbajti një mbledhje, ku njëra nga pikat ishte një letër nga partia politike Lidhja Demokratike e Dardanisë në lidhje me zgjedhjen e nënkryetarit të Komunës për Komunitete. Në procesverbal të mbledhjes theksohet si në vijim:

"Kryetari ka thënë se më 04.06.2010 ka marrë një shkresë nga Lidhja Demokratike e Dardanisë, LDD, me të cilën është kërkuar që pika e re e rendit të ditës të diskutohet në komuna. Por, kjo është seancë e

jashtëzakonshme, kështu që kjo pikë nuk do të përfshihet në rend të ditës. Ata kanë kërkuar që të zgjidhet nënkryetari i Kuvendit nga komunitetet, dihet se në këtë post është i zgjedhur A.K. nga e njëjta parti më 28.01.2010, kështu që me siguri është bërë gabim në përkthim dhe me siguri është kërkuar që të zgjidhet nënkryetari i Komunës nga komuniteti pakicë. Kryetari ka thënë se ka biseduar me kryetarin dhe ai i është përgjigjur se nënkryetar nuk mund të jetë dikush që nuk është banor i komunës së Graçanicës, dhe që në shkresë nuk është shkruar emri i kandidatit, por sipas disa informatave, ai është nga rrethina e Pejës dhe Klinës, dhe që tani ai jeton në Prishtinë. Dihet se propozimi për nënkryetarin nga komuniteti ujen nga propozimi i vetë kryetarit, por ende propozimi nuk është paraqitur. Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale numri i komunitetit pakicë duhet të jetë 10% që të kenë të drejtën për këtë post, i cili zgjidhet çdo 4 vjet.

Kryetari ka thënë se në komunën e Graçanicës, shkalla e numrit të komuniteteve pakicë është: romë 10,6%, shqiptarë 3,6%, goranë 1,8% dhe deri tani propozimin e ka paraqitur vetëm kjo parti shqiptare, LDD, dhe me siguri do të paraqitet edhe nga komuniteti rom, por Kuvendi nuk mund ta miratojë propozimin derisa vetë kryetari nuk e bën propozimin e tij, dhe për këtë post duhet të dihet e tërë biografia e personit.

Deputeti A.K. nga LDD-ja ka thënë se ai e di se sipas Ligjit, nënkryetari i kryetarit të Kuvendit zgjidhet me votime, dhe pajtohet se është bërë gabim në përkthim. Një nënkryetar komunal mund të zëvendësohet nëse tre muaj nuk ka marrë pjesë në seanca, apo nëse ka bërë ndonjë gabim shumë të madh, kështu që nuk mund të zëvendësohet dhe për këtë ka kompetencë vetëm kryetari i Komunës dhe nuk i ujen mirë se personi i propozuar nuk është nga komuna e Graçanicës, por pajtohet me propozimin e partisë së tij dhe e di se propozimin e jep vetë kryetari. Tani propozimi shkon në Kuvend për miratim dhe për këtë arsye, partia LDD ka pasur nevojë këtë shkresë t'ia paraqesë në fillim kryetarit, tani Kuvendit.”

15. Më 24 qershor 2010, kryetari i Komunës së Graçanicës kërkoi nga z. A.K., kryetar i Komisionit për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve në Komunën e Graçanicës, “[...] një rekomandim për emërimin e nënkryetarit të Komunës, i cili do të merret me çështjet e komuniteteve.”
16. Më 4 prill 2013, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e njoftoi kryetarin e Komunës së Graçanicës se “bazuar në nenin 61 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, komunat ku të paktën 10% e qytetarëve u përkasin komuniteteve joshumicë, do të kenë një nënkryetar të Komunës për Komunitete. Nënkryetari i Komunës për Komunitete propozohet nga kryetari i Komunës dhe miratohet nga Kuvendi i Komunës sipas nenit 61.3 të Ligjit për vetëqeverisje lokale.”
17. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal gjithashtu njoftoi se “gjatë monitorimit të Komunës së Graçanicës, është konstatuar se në këtë komunë ende nuk është emëruar nënkryetari i Komunës për Komunitete, ashtu siç është parashikuar me ligj. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, bazuar në të gjeturat e cekura më lart dhe duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisjen lokale, kërkon nga organet e Komunës përkatësisht nga kryetari i Komunës që

të propozojë në Kuvendim e Komunës emërimin e nënkryetarit të Komunës për Komunitete në pajtim me paragrafin 1 të nenit 61 të Ligjit për vetëqeverisje lokale.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi pretendon se kryetari i Komunës së Graçanicës *“në mënyrë të vazhdueshme me mosveprim dhe veprim në kundërshtim me Kushtetutën, Ligjin dhe Statutin e Komunës i cenon dhe i shkel:*
 - a. *Të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë të anëtarëve të komunitetit joshumicë në Komunën e Graçanicës për përfaqësim si një komunitet,*
 - b. *Të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë të z. Milazim Gashi në mënyrë individuale në ushtrimin e votës dhe profesionit”.*
19. Prandaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese, *“të bëjë interpretimin përfundimtar se a janë veprimet dhe mosveprimet e kryetarit të Komunës së Graçanicës në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës, konkretisht me nenet 62, 123, 124 dhe për rastin individual nenet 45 e 49 të Kushtetutës.”*
20. Parashtruesi pretendon se *“kryetari i Komunës së Graçanicës, Bojan Stojanović, i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli, vazhdimisht prej se ushtron detyrën publike, me mosveprime dhe veprime të qëllimshme bën shkelje kushtetuese; sepse nuk procedon zgjedhjen e zëvendëskryetarit të Komunës, në këtë rast z. Milazim Gashit në pozitën që i takon me Kushtetutë si përfaqësues i komunitetit joshumicë të propozuar nga përfaqësuesi i komunitetit joshumicë në Asambleenë Komunale .”*
21. Parashtruesi më tutje pretendon se *“Asambleja Komunale disa herë ka ngritur çështjen e moszgjidhjes së nënkryetarit të Komunës [...]”.*

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata së pari i referohet nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”
24. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton se:
 1. *Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar*
(...)

7. "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

25. Për më tepër, Gjykata merr parasysh nenin 47 [Kërkesat Individuale] të Ligjit, i cili parasheh se:

*1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individë mund ta ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

26. Për më tepër, Gjykata gjithashtu merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh se:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë."

27. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (3.c) të Rregullores së punës, i cili parasheh se:

"(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur: c) kërkesa parashtrrohet nga një palë e paautorizuar;"

28. Gjykata vëren se parashtruesi nuk e ka specifikuar asnjë akt të autoritetit publik (shih nenin 48 të Ligjit) që pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat dhe liritë e tij individuale, të garantuara me Kushtetutë dhe konventa ndërkombëtare që zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.

29. Përveç kësaj, Kushtetuta nuk parasheh *actio popularis*, që është një modalitet i ankesës, çfarë u mundëson individëve, të iniciojnë shqyrtim abstrakt, pa marrë parasysh interesin e tyre specifik ligjor në rastin në fjalë.

30. Në fakt, neni 113.7 i Kushtetutës presupozon një shkelje individuale dhe të drejtpërdrejtë për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese si një mundësi e fundit për një shkelje të pretenduar nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive individuale, të garantuara me Kushtetutë.

31. Kjo konsideratë vërtetohet nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas së cilës, *"sistemi i peticioneve individuale ... përjashton parashtrimet me anë të actio popularis. Prandaj, ankesat duhet të sillen nga apo në emër të personave që pretendojnë se janë viktimë të një apo më shumë shkeljeve të dispozitave të Konventës. Këta persona duhet të jenë në gjendje të tregojnë se janë "prekur drejtpërsëdrejti" nga masa e ankuar"* (shih p.sh. Aktgjykimi në rastin Ilhan kundër Turqisë, Nr. 22277/93, 27 qershor 2000, paragrafi 52).

32. Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar që të mund të referojë çështje kushtetuese *in abstracto* përkitazi me zgjedhjen ose moszgjedhjen e nënkryetarit të Komunës së Graçanicës, në mënyrë që të arrijë një mjet në emër të interesit kolektiv.
33. Prandaj, kërkesa është e papranueshme në bazën a lartpërmendur.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 dhe nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (3.c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 4 korrik 2013, njëzëri


VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe,
- IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani